



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**ZL.Anr.450/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Rafet Haxhaj dhe Zyhdi Haziri anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lartë Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e Ivica Ceniq nga fshati Gornje Kusle të Novobëdes, paraqitur kundër Zhivorad Stojković kryesues i KVV-së në vendvotimin 1412/02D për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017 në seancën e panelit të mbajtur me 24.10.2017, mori këtë:

### **V E N D I M**

**HUDHET** si e pa lejuar ankesa e Ivica Ceniq nga fshati Gornje Kusle të Novobëdes, paraqitur kundër Zhivorad Stojković kryesues i KVV-së në vendvotimin 1412/02D për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave.

### **A r s y e t i m**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 23.10.2014, nga Ivica Ceniq nga fshati Gornje Kusle të Novobëdes në të cilën pretendon për parregullsi gjatë numërimit të votave të kandidatëve të subjektit politik Lista Serbe. Parashtruesi i ankesës thekson se kutia e votimit së bashku me materialin zgjedhor është dorëzuar në KKZ duke qene e hapur, dhe procesverbali me rezultatet e votimit nuk është paraqitur ne vendvotim pas përfundimit te numërimit.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankeses gjeti se:

### **Ankesa është e pa lejuar**

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar në ankesë përkitazi me parregullsit në vendvotimin 1412/02D, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së ankuesit Ivica Ceniq, nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa**  
ZLAnr.450/2017 më datën 24.10.2017.



***Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.***